



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

Nr. 1359 Prot.

Tiranë, më 19.02.2015

UDHËZIM

Nr. 3, datë 19.02.2015

PËR

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 15.08.2014 "PËR ZHVILLIMIN
PROFESIONAL TË PUNONJËSVE ARSIMOR"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 58 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridik" dhe të ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 "Për lejet, autorizimet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 2 e nenit 6 të Udhëzimit Nr. 26, datë 15.08.2014 "Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimor", ndryshon si vijon:
"Tre ditë trajnimi përmbajnë 18 orë dhe pasqyrojnë 1 kredit".
2. Pika 3 e nenit 6 të Udhëzimit Nr. 26, datë 15.08.2014 "Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimor", ndryshon si vijon:
"Një punonjës mësimor duhet të realizojë së paku tre ditë trajnimi në vit".
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në MAS, IZha, AKP, ISha, DAR/ZA, institucionet arsimore dhe agjencitë trajnuese.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA



Nr. 23, AL-1001, Tiranë
Tel: +355 4 2222260, Fax : +355 4 2232002

Web site: www.mash.gov.al